

RELACION TEKNIK

PER KONSULTIMIN ME PUBLIKUN

Perpunim, ambalazhim dhe tregetim duhani



Shkurt 2019

Pershkrimi dhe organizimi i punes per aktivitetin “Perpunim Industrial i duhanit|”

Teknologjia e prodhimit te duhaneve te presuara eshte ne perputhje me kerkesat teknike dhe ato ligjore qe rrjedhin nga neni 16 I ligjit Nr. 8691, date.16.11.2000, dhe ploteson Standartin Shqiptar S SH 1421-88, dhe S SH 3940-87.

Ambalazhimi – tonga me peshe mesatare 20-29 kg ne forme kuboidi realizohet me material bimor te thurur me fije celuloze dhe pelhure te trash. Manipulimi i duhaneve fillon me procesin e grumbullimit, dhe shfletosjes, te cilat kryhen ne ambjent te paster, ndersa lageshtia e duhanit eshte ne vlera 14-17% per duhanet orientale dhe gjysem orientale, dhe 16-18 % per duhanet gjethe medha. Klasifikimi behet ne perputhje me llojin, duart, ngjuren, dhe cilesine perkatese. Nje analize referuese per secilen cilesi kryhet ne AKDC (Agjencia Kombetare e Duhan-Cigareve).

Ambalazhimi i tongave behet ne madhesine 900X650, me materialin e pershkruar me siper dhe shtrengohet me spango te trash. Etiketimi – ne cdo tonge shenohet lloji i duhanit, cilesia, vendi i prodhimit, data e ambalazhimit dhe pasha. Duhanet tona jane te fermentuara natyralisht ne ambjentet e fermes se prodhimit, kurse treguesit fiziko-kimike jane ne perputhje me S SH 1561:87, S SH 1561-1:87, S SH 1561-2:87, S SH 1561-3:87 dhe lidhen perkatesisht me marrjen e mostres, percaktimin e lageshtires, percaktimin e hirit, percaktimin e shkalles se fermentimit. Duhanet e prodhuara ne kete menyre ruhen ne ambjente te pershtatshem me temperature 16-20 °C dhe lageshti relative 60-70 %, per nje periudhe kohore jo me shume se 3 vjet.

Lendet e para dhe ndihmuese dhe karakteristikat kryesore te tyre

Lende e pare per manipulimin e duhaneve eshte duhani i zgjedhur ne fermat e prodhimit te duhanit. Brenda ne territorin shqiptar me karakteristika organo-shqisore dhe fiziko kimike te kerkuara. Materialet ndihmese jane materialet e ambalazhimit, lengjet embelsuese, dhe aromat, te gjitha natyrale dhe te prodhuar nga kompani te certifikuara me standartet aktuale.

Produktet e gatshme dhe karakteristikat kryesore te tyre (kryesisht per mbrojtjen e shendetit te konsumatoreve) Produkti yne eshte i lire nga lendet e huaja (pluhur, material joduhanore,pjese metalike), per arsye te trajtimit te realizuar, gjithashtu nuk ka pesticide ne materialin duhanor.

Aktiviteti i perpunimit industrial te gjetheve te duhanit perfshin por pa u limituar:

- Zgjedhjen e llojit te duhanit ne perputhje me cilesine e tokes dhe kushtet klimatike

- Mbjellja dhe perpunimi i bimeve
- Vjelja, transporti, tharja (zverdhja) dhe konservimi pas tharjes
- Manipulimi i duhaneve, pastall dhe varg, mirembajtja e duhaneve te manipuluar
- Fermentimi natyral
- Trajtimi me avull
- Shfletosja dhe klasifikimi
- Harmanizimi
- Tharja dhe manipulimi ne toga
- Ruajtja e produktit ne magazine



Figura 1: Fusha te mbjella me duhan



Figura 2: Tharja e gjetheve te duhanit

Pershkrimi i procesit teknologjik

Procesi teknologjik i perpunimit te duhaneve ne fabriken tone konsiston ne klasifikimin e rakoltes sipas brezave, ne pjesen e fabrikes qe eshte destinuar per manipulim. Duhani vendoset ne rafte druri me tre kate, duke pasur parasysh qe ngarkesa e kesaj pjese most e jete me e madhe se 100 kg/m^2 . Ndricimi eshte artificial rreth 100 luks/m^2 dhe e gjithë fabrika eshte e aklimatizuar. Pas ripeshimit te dengave te ardhur nga ferma, aplikohet trajtimi me avull per te zhvilluar karakteristikat e llojit dhe per te lejuar veprimet e tjera. Klasifikimi sipas cilesive kryhet manualisht dhe automatikisht dhe pergatiten siloset per harmanizim. Ne fund te procesit kryhet manipulimi ne tonga.




Figura 3: Procesi teknologjik

Tipi dhe sasia e lendes se pare te perdorur

Lendet e para te aktivitetit te perpunimit industrial jane gjethet e duhanit sipas llojeve te meposhtme

- ✦ Oriental (Turk, Elbasan, Llovina)
- ✦ Gjysem oriental (Koplik, Postribe)
- ✦ Duhane Gjethe Medhenje (Virgjinia, Burlej, Mariland, Duhane te Zeza)
- ✦ Si dhe duhane importi te llojeve dhe cilesive te ndryshme.

IGLA shpk furnizohet me energji nga rrjeti shperndares ekzistues. Por zoterrojme dhe nje gjenerator qe perdoret ne rast te mungeses te energjise elektrike. Konsumi mesatar ditore ne baze te diteve te punes **320 kWh/dite**

IGLA Sh.p.k ka ndertuar nje pus, nga ku merr uje per procesin teknologjik, pastrimin, lagien e ambientit, si dhe ne rast te renies se zjarrit. Nevoja per uje teknologjik eshte 20 m³ uje/dite. Ne procesin e prodhimit perdoren lende te para dhe ndihmese si: Gjethe duhani, Leter celuloze, Material bimor, Tekstil i trashe, Lende djegese Mazut (nafte). Vellimi i perpunimit do te jete 0.3 ton/dite duhane (prodhim vendi dhe nga importi, te shperndara ne varesi te kerkeses).

Makinerite dhe pajisjet

Pajisjet kryesore qe do te perdoren dhe disponon subjekti "IGLA" sh.p.k pasqyrohet ne tabelen e meposhtme.

Emertimi	sasia
Cilinder Zbutje	1 cope
Transportjer	8 cope
Silos	2 cope
Cilinder tharjeje	1 cope
Pres per tonga	2 cope
Gjenerator	1 cope
Impiant trajtimi uje	1 cope
Kaldaje avulli	1 cope
Kondicioner	1 cope
Mjete transporti	3 cope

Kushtet e magazinimit te produktit te duhanit

Duhani i grumbulluar ruhet ne ndertese te izoluar mire nga ambientit i jashtem, dhe qe i pergjigjet procesit teknologjik te prodhimit, qendra jone e perpunimit dhe e manipulimit perbehet:

1. Seksioni i depozitimit te duhanit
2. Seksioni i shfletosjes
3. Seksioni i manipulimit "tonga"
4. Dhoma teknike (Uje, Energji, Klimatizator)



5. Seksioni i zbutjes se duhanit
6. Seksioni i materialeve ndihmese dhe pjeseve te nderrimit

Duhanet e perpunuara kalojne ne kontroll te pergjithshem cilesor dhe grupohen ne lote 25 ose 50 ton.

Vendosja e dengjeve behet ne pozicion pllake 5-6 dengje njeri mbi tjetrin ne blloqe te medha duke lene midis tyre rruge kalimi me gjeresi 50-80 cm. gjate qendrimit duhani peson transformime te vazhdueshme. Kushtet tona te ruajtjes jane: temperature 16-20 ° C dhe lageshtia relative e ajrit 65-75%.

Duhanet e vendosur ne vjeterim levizin nje her ne 15-20 dite. Mbas ambalazhimit dengjet peshohen dhe marketohen, duke specifikuar por pa limituar ne fabriken e prodhimit, Vitin e Prodhimit, Pesha bruto, Numri i Lotit. Cdo lot shoqerohet me fletspecifikimet, analizat laboratorike dhe garancine.

Vendndodhja e zonës së projektit

Impianti eshte impiant ekzistues i paisur me Leje Mjedisi ne date 21.05.2013, por duke qene se Ligji Nr.10081, dt. 23.02.2009 ka ndryshuar subjekti ne baze te Ligjit te ri Nr. 10448 po ndjek procedusren per tu paisur me Leje te re. Instalimi i impiantit per perpunimin e duhanit, ambalazhimin, tregetimin e tij dhe te aksesoreve te tij, ka nje sipërfaqja totale e sheshit është 2500 m², nga kjo sipërfaqe 850 m² eshte sipërfaqe ndertese. Sheshi ndodhet në fshatin Vaqarr, Njesia Administrative Vaqarr, Tirane.

